

VENDIM
Nr. 61, datë 26.1.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 737, DATË
17.9.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
RREGULLAVE PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT KOMBËTAR TË KUJDESIT
TË TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 737, datë 17.9.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“7. Struktura kryen këto funksione:
 - a) harton dhe propozon drejtimet kryesore, në përputhje me pikën 3, të këtij vendimi;
 - b) propozon shpalljen publike të thirrjes, duke përcaktuar procedurat e aplikimit si dhe kriteret e vlerësimit për administrimin e Fondit në bazë të programit e të llojit të financimit;
 - c) ndjek dhe zbaton procedurat e administrimit të thirrjes për aplikime;
 - ç) harton dokumentacionin e nevojshëm dhe kontratën e lidhur me përfituesin e projektit;
 - d) harton raportet financiare dhe administron programin financiar të Fondit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;
 - dh) harton raportin vjetor për përdorimin e Fondit, në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për buxhetin, pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - e) monitoron zbatimin e projekteve të financuara nga Fondi;
 - ë) mbledh të dhëna, harton statistika dhe informacione lidhur me përdorimin e Fondit;
 - f) kryen dhe detyra të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, sipas shkronjës “d”, të nenit 264, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.”;
 - b) pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:
“7/1 Deri në miratimin e strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave të Fondit, krijohet një strukturë *ad hoc* për administrimin e Fondit, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.”.
2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama